



Në bazë të dispozitave të nenit 12 parag. 12.2 pika (d.), e lidhur më nenin 40 parag. 40.2 pika (g.) të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 2 dhe 8 të Ligjit 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, si dhe nenit 10 parag. 1 pika 3 e lidhur më nenin 40 parag. 2 pika 6 të Statutit të Komunës së Klinës, si dhe duke iu referua Iniciativës nr. 05-430-5330/2015 të dt.30.09.2015 të Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, lidhur më Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores komunale për Tarifat, Ngarkesat dhe Gjobat komunale të dt.29.08.2014, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e vetë të rregullt të XI-ën më radhë të vitit 2015, të mbajtur më dt.30.12. 2015, miratoj:

## V E N D I M

### Për

**Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores komunale për Tarifat, Ngarkesat dhe Gjobat komunale nr. 01-434-4863/2014 të miratuar më dt.29.08.2014**

### I

**MIRATOHET** Vendimi për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Tarifat, Ngarkesat dhe Gjobat komunale nr. 01-434-4863/2014, e miratuar më dt. 29.08.2014.

### II

Teksti i ndryshimeve dhe plotësimeve sipas drejtorive komunale është si në vijim:

Në kuadër të Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, në nenin 21 pas pikës 21.2 shtohen edhe 2 pika të reja, që kanë të bëjnë më tarifat për Noter dhe për Përmbarues Privatë, më këtë përmbajtje:

- 21.3 Noteret..... vlera e tarifës vjetore në lartësi prej.....150,00€.  
21.4 Përmbaruesit Privat..... vlera e tarifës vjetore në lartësi prej.....150,00€.

Pas këtyre pikave rregullohet renditja e pikave tjera të asaj dispozite.

Po ashtu në kuadër të Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, mbi nenin 25 caktohet titulli i ri më këtë përmbajtje:

## Regjistrimi i automjeteve dhe tarifat për automjetet transportuese

Paragrafi 1 pika 1 dhe 2 e nenit të mëparshëm 25 mbetet e njëjtë, por pas paragrafit 1 caktohen edhe paragrafët tjera dhe teksti i kësaj dispozite modifikohet dhe caktohet si në vijim:

Personat fizik dhe juridik janë të obliguar të kenë leje për pronësinë e veturës.

Për të marrur një leje të tillë personat fizik dhe juridik duhet të kenë dëshmi mbi regjistrimin e automjetit motorik të autoritetet kompetente.

Për lëshimin e lejes pronarët-poseduesit e automjeteve motorike duhet të paguajnë në baza vjetore tarifën, dhe atë si në vijim:

- a. Për automjetet dhe automjetet taksi benzinë-naftë deri 3500ccm.....10,00€  
Për automjetet dhe automjetet taksi benzinë-naftë mbi 3500ccm.....20,00€
- b. Për kamionët që bëjnë transportin e mallrave benzinë-naftë deri 3,5 ton.....10,00€  
Për kamionët mbi 3,5 ton.....20,00€
- c. Për autobusët e transportit të udhëtarëve.....20,00€.

Nga tarifat e lartshënuara, lirohen automjetet në pronësi të institucioneve shtetërore, përfaqësive diplomatike, emergjencës (makinat e zjarrfikësve, të ndihmës së shpejtë, si dhe makinat e komunitetit fetar për shërbime fetare), ato të invalidëve të punës, civilë dhe ushtarakë. Provë për këtë është leja e qarkullimit të automjetit, apo dokumenti tjetër që dëshmon pronësinë.

Licenca për ushtrimin e veprimtarisë së operatoreve transportues lëshohet sipas kushteve dhe kritereve ligjore nga Ligji për Transportin Rrugor, në bazë të aktit përkatës nën ligjor të ministrisë së linjës si dhe aktit tjetër nën ligjor të veçantë të komunës (neni 7 i Ligjit për Transportin Rrugor).

### III

Në kuadër të Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, tarifat e mëparshme të paragrafit 2 dhe 3 të nenit 39, ndryshohen dhe propozohen të jenë më këto vlera të reja si në vijim:

Ngarkesa për demolimin e objekteve pa leje caktohet.....1.50 € për m<sup>2</sup>.  
Ngarkesa për rregullimin e pronës pas demolimit caktohet.....0.25 € për m<sup>2</sup>.

Teksti tjetër i nenit 39 mbetet i pa ndryshuar.

Paragrafi 1 i nenit 42 ndryshohet dhe teksti i ri ka këtë përmbajtje:

Për ndërrimin e destinimit të objektit banesor në lokal afarist dhe nga lokali afarist në objekt banimi për kategorinë 1 dhe 2 caktohet taksa prej .....2,00€ për m<sup>2</sup>.

Po ashtu në nenin 42 pas tarifës 42.4 shtohet edhe tarifa e re më këtë përmbajtje:

42.5 Leja për rrënim, caktohet tarifa fikse prej..... 25,00€ për m<sup>2</sup>.

Në nenin 44 tarifa e re caktohet të jetë më tekstin si në vijim:

Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore bëhet sipas tarifës prej.....0.50€ për metër gjatësi.

Nga neni 49 hiqet pika e 5 e tij, sa i përket Pëlqimit mjedisor, sepse kjo çështje është e rregulluar më aktin e veçantë Rregulloren për Dhënieën e Lejeve mjedisore komunale-LMK-ën.

#### IV

Në kuadër të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në paragrafin 3 të nenit 60 pas pikës 3 shtohet pika 4 më këtë përmbajtje:

4. Shfrytëzimi i pajisjeve të zerimit të sallës të Objektivit të Qëndresë së Kulturës „Jehona e Dukagjinit, caktohet tarifa në vlerë prej.....50,00€.

Po ashtu në nenin 60 pas paragrafit të 5 shtohen 2 paragrafe të reja, ai i 6 më këtë përmbajtje:

Për shfrytëzimin e fushës së futbollit të qytetit të Klinës „18 Qershori,“ caktohet tarifa në vlerë prej ..... 15,00€ për 1 orë.

Paragrafi i 7 i nenit 60 shtohet më këtë përmbajtje:

Për shfrytëzimin e fushës së futbollit të qytetit të Klinës „18 Qershori,“ nga ana e shkollave të futbollit në ligën rajonale, caktohet tarifa në vlerë prej.....10,00€ për 1 orë.

#### V

Ky Vendim është i plotfuqishëm dhe hyn në fuqi nga dita e miratimit dhe konfirmimit të ligjshmërisë së tij nga Komisioni i përbashkët i MF-ve dhe MAPL-ës.

#### VI

Inkorporimin e këtij Vendimi në tekstin e spastruar të rregullores lëndore, si dhe rregullimet dhe renditjet tjera tekniko-juridike do të bëjë Zyra Ligjore së bashku me Shërbimin për Punë të Kuvendit.

#### VII

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Iniciativa e Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit në Klinë nr. 05-430-5330/2015 e dt. 30.09.2015 si dhe propozimet e tjera të resorëve tjerë për plotësimet dhe ndryshimet e Rregullores për Tarifat Ngarkesat dhe Gjobat komunale e cila ishte miratuar më dt. 29.08.2014.

#### VIII

Më Vendim të njoftohen: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, Kryetari i Komunës, Komisioni i përbashkët i MF-ve dhe MAPL-ës në Prishtinë, një kopje publikohet në tabelën

e shpalljeve, një publikohet në web faqen zyrtare të Komunës, një kopje mbetet për Zyrën Ligjore dhe Shërbimin për Punë të Kuvendit, si dhe një kopje Arkiva.

Nr. 01-06-70/2015  
Klinë, më dt. 06.01. 2015

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

